

V E N D I M
Nr.279, datë 8.7.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të nenit 18, paragrafi i dytë i ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në pjesën e Rregullores “Për Kryesinë, Komisionet e Përhershme e të Përkohshme dhe Byronë e Grupit Ndërparlamentar të Kuvendit Popullor”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pas nenit 3 shtohet neni 3/a me këtë përmbajtje:

“Kryesia e Kuvendit Popullor në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare organizon mbledhje javore për veprimtarinë e Kuvendit Popullor dhe për problemet e tjera që mund t’i dalin. Në këto mbledhje merr pjesë detyrimisht edhe një anëtar i Qeverisë ose person i barazuar me të për mbajtjen e lidhjeve me Kuvendin Popullor.”

II. Në pjesën e rregullores “Për sesionet dhe mbledhjet e Kuvendit Popullor, grupet parlamentare dhe kontrolli parlamentar”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në nenin 9, në fund të paragrafit të dytë, hiqet fjalia: “Në mbledhje merr pjesë edhe një anëtar i Qeverisë” dhe zëvendësohet me fjalinë: “Në mbledhje merr pjesë detyrimisht edhe një anëtar i Qeverisë ose person i barazuar me të për mbajtjen e lidhjeve me Kuvendin Popullor”.

2. Në nenin 12 në fund, hiqet fjalia: “Në këtë rast ftohet edhe një anëtar i Qeverisë”, dhe zëvendësohet me fjalinë” “Në këtë mbledhje merr pjesë detyrimisht anëtar i Qeverisë ose personi i barazuar me të.

3. Në nenin 28 hiqet paragrafi i parë dhe në vend të tij shtohen 3 paragrafë me këtë përmbajtje:

“Koha e përgjithshme e diskutimeve, me përjashtim të rasteve kur në këtë rregullore parashikohet ndryshe, caktohet nga Kryesia e Kuvendit Popullor pas konsultimit me kryetarët e grupeve parlamentare, por në çdo rast nuk mund të jetë më shumë se 120 minuta. Ajo ndahet në mënyrë proporcionale ndërmjet grupeve parlamentare, sipas numrit të deputetëve që ato kanë, por në çdo rast nuk mund të jetë më pak se 10 minuta për çdo grup.

Çdo grup parlamentar ndan vetë midis deputetëve kohën që ka në dispozicion.

Deputetët që kanë kërkuar të diskutojnë, por që nuk mund ta marrin fjalën për shkak të mbarimit të kohës, kanë të drejtë të depozitojnë në sekretari diskutimin me shkrim.

4. Pas nenit 30 shtohet neni 30/a me këtë përmbajtje:

“Kur projektligjet shqyrtohen në parim, ka të drejtë të diskutojë çdo deputet. Në këtë rast, kryetari i Kryesisë u jep fjalën deputetëve sipas radhës së regjistrimit, duke harmonizuar diskutimin ndërmjet deputetëve sipas grupeve parlamentare”.

5. Pas nenit 30/a shtohet neni 30/b me këtë përmbajtje:

“Propozimet për ndryshime, heqje apo shtime të neneve të reja nuk mund të paraqiten direkt në seancë plenare, në rast se ato nuk i janë dhënë më parë me shkrim komisionit përkatës për shqyrtim e diskutim.

Pasi propozimet kanë ndjekur procedurën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, ato shqyrtohen në seancë duke diskutuar një deputet “pro” e një “kundër”.

Propozimet që kanë të bëjnë me ndreqje gjuhësore dhe redaktoriale që nuk prekin përmbajtjen e ligjit mund të bëhen edhe direkt në seancë.

6. Pas nenit 30/b shtohet neni 30/c me këtë përmbajtje:

“Pas votimit në tërësi mund t’u jepet fjala përsëri kryetarëve të grupeve parlamentare, si dhe deputetëve që mbajnë qëndrim të kundërt me grupin e vet parlamentar lidhur me projektligjin që votohet”.

7. Neni 72 ndryshohet si vijon:

“Për krijimin e një grupi parlamentar kërkohet një numër minimal prej 5 deputetë.”

8. Në nenin 73 pas paragrafit të dytë, shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Grup të vetëm të përzier mund të formojnë dhe deputetët që nuk i përkasin një partie ose që nuk kanë të njëjtin orientim politik kur plotësojnë kërkesën e parashikuar në nenin 72.

“Kur një grup deputetësh me të njëjtën përkatësi partiake ose orientim politik nuk është i pranishëm brenda tri ditëve që nga fillimi i mbledhjes së parë të Kuvendit Popullor, kur plotësojnë kërkesën e nenit 72 të kësaj rregulloreje, mund të bëjnë deklarinë e formimit të grupit parlamentar brenda tri ditëve duke filluar nga data e paraqitjes.

9. Neni 75 ndryshohet si vijon:

“Çdo grup parlamentar në mbledhjen e parë të tij zgjedh kryetarin dhe sekretarin e përgjithshëm.

Për zgjedhjen e tyre si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm që mund të bëhet për ta, ose të grupeve parlamentare, vihet në dijeni Kryesia e Kuvendit Popullor.

Në grupin e përzier, zgjedhja e kryetarit dhe e sekretarit të përgjithshëm bëhet duke pasur parasysh raportin e elementëve politikë të përfaqësuar në këtë grup.

10. Në nenin 82 pas paragrafit të katërt shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

Kur deputeti dëshiron edhe t'i lexojë në sallë pyetjet para se t'ia paraqesë me shkrim ato Kryesisë së Kuvendit Popullor, ka në dispozicion vetëm 2 minuta.

11. Në nenin 83, paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

“Në të njëjtën seancë nuk mund të shqyrtohen më tepër se dy pyetje të bëra nga i njëjti deputet, ndaj të njëjtit subjekt të parashikuar në nenin 82 dhe për të njëjtën çështje. Kanë përparësi pyetjet pa debat.

12. Neni 91, paragrafi i parë të ndryshohet si vijon:

“Deputeti që ka paraqitur një interpelancë ka të drejtën e shpjegimit të saj. Pas deklaramit të organit që interpelohet, ai ka të drejtë të shprehë arsyet për të cilat është ose jo i kënaqur me përgjigjen e dhënë. Koha në dispozicion të deputetit, si për shpjegimin e interpelancës, ashtu dhe për të shprehur nëse ai është i kënaqur ose jo me përgjigjen e dhënë, është 15 minuta. Kjo kohë ndahet sipas dëshirës së deputetit për të dy pjesët e interpelancës, por ai detyrohet të vërë në dijeni Kryesinë e Kuvendit Popullor për mënyrën e kësaj ndarjeje.”

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.